

VENDIM
Nr. 21, datë 4.4.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 4.4.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 39 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Arben Gjoleka

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë Veri, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si rrjedhojë e mospërfundimit të gjykimit të çështjes gjyqësore administrative nr. 31151-01451-86-2022, nr. akti 16849, datë 4.5.2022 nga Gjykata Administrative e Apelit.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-2963, datë 13.7.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe dërgimi për rishqyrtim i çështjes pranë tij.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Arben Gjoleka (*kërkuari*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjekteve të interesuara Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (*ASHK*) dhe Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Tiranë Veri, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me kontratën e shitblerjes nr. 1364 rep., nr. 119 kol., datë 24.3.1998, kërkuari ka blerë një apartament me sipërfaqe 70 m², të cilin e ka regjistruar në Zyrën Vendore të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me adresë rruga “Marsel Kashen”, Tiranë. Ky apartament është ndërtuar mbi bazën e lejes së ndërtimit të miratuar me vendim të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë për objektin shtesë kati. Referuar aktit të kolaudimit të apartamentit që ka blerë kërkuari, ka rezultuar se sipërfaqja

faktike e tij nuk është 70 m², por 84 m². Në këto kushte, kërkuesi ka bërë dy aplikime, duke kërkuar nga Drejtoria Vendore e ASHK-së, Tirana Veri korrigjimin e të dhënave kadastrale të pasurisë së tij. Duke qenë se nuk ka marrë përgjigje për aplikimet e tij, ai i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, e cila i ka kërkuar Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Tirana Veri të marrë masa për dhënien e shërbimit. Kjo e fundit ka refuzuar aplikimin e kërkuesit, duke arsyetuar se, nisur nga fakti se kontrata e shitblerjes është regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme me sipërfaqe 70 m², nuk mund të procedohet me korrigjimin e sipërfaqes. Në vijim kërkuesi i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, e cila ka refuzuar ankesën e tij për ndryshimin e sipërfaqes së pasurisë.

2. Në këto kushte, më datë 31.3.2021, kërkuesi i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar detyrimin e Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Tirana Veri të korrigjojë gabimin material në kontratën e shitblerjes lidhur me sipërfaqen e pasurisë së paluajtshme objekt shitblerjeje; të korrigjojë gabimin në pasqyrimin e të dhënave kadastrale në regjistrin e pasurive të paluajtshme, në kartelë dhe në hartën kadastrale të pasurisë në raport me dokumentacionin e pronësisë ose me gjendjen faktike të saj në terren; të nxjerrë vendimin (aktin administrativ) për kalimin e pronësisë, privatizimin e pjesës takuese të truallit shtetëror në përdorim për pasurinë; të japë informacion për emrin e subjektit pronar ose bashkëpronar mbi truallin funksional të pasurisë, si dhe shkakun ligjor të fitimit të pronësisë mbi këtë truall; të dorëzojë të plotësuar kartelën e pasurisë së paluajtshme, duke shënuar/pasqyruar në të emër, atësi, mbiemër të subjekteve bashkëpronare mbi këtë pasuri, ekstremitetet e akteve të fitimit të pronësisë nga bashkëpronarët mbi njësitë ndërtimore të pasurisë, si dhe emërtimin e këtyre akteve; të kthejë vlerën e tarifës në masën 4.200 lekë, të paguar në mënyrë të padetyruar.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 575, datë 24.2.2022, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së kërkuesit, si dhe rrëzimin e padisë vetëm për kërkimin e parë që lidhej për detyrimin e Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Tirana Veri për të korrigjuar gabimin material në kontratën e shitblerjes, për sa i përket sipërfaqes së pasurisë së paluajtshme. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim Avokatura e Shtetit dhe Drejtoria Vendore e ASHK-së, Tirana Veri, si dhe kundërankim kërkuesi. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31151-01451-86-2022, nr. akti 16849, datë 4.5.2022 dhe është ende në pritje të gjykimit.

4. Sipas informacionit të Gjykatës Administrative të Apelit çështja i ka kaluar me short fillimisht gjyqtarës A.N. dhe më pas gjyqtarës R.S. më datë 3.6.2022; gjyqtarit S.I. më datë 29.7.2022 dhe aktualisht është për shqyrtim nga gjyqtari relator A.D., të cilit i ka kaluar më datë 19.9.2023. Gjykata Administrative e Apelit ka 11 gjyqtarë dhe gjyqtari relator ka 1346 çështje në shqyrtim. Aktualisht kjo gjykatë po shqyrtonte çështjet e regjistruara në vitin 2017, si dhe çështjet me përshpejtim me kërkesë të palëve sipas vendimit nr. 78, datë 30.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit” (*vendimi nr. 78/2019 i KLGJ-së*).

5. Më datë 5.5.2023, kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë me objekt konstatimin e shkeljes, tejzgjatjes së gjykimit në afat të çështjes gjyqësore administrative nr. 31151-01451-86-2022, nr. akti 16849, datë 4.5.2022 dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2963, datë 13.7.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës me argumentin se mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrimet abuzive të gjyqtarit. Ky kolegji ka arsyetuar se nuk mund të konstatohet shkelja e afatit të arsyeshëm dhe të urdhërohet gjykimi i çështjes, pasi mosgjykimi i çështjes vjen për shkak të pamundësisë objektive dhe jo për shkak të neglizhencës së gjyqtarit relator. Për më tepër, ky kolegji ka evidentuar se nga palët nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përshpejtimin e kësaj çështjeje.

7. Me kërkesën e datës 3.8.2023, e cila është plotësuar më datë 4.9.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit. Kolegji i Gjykatës, më

datë 19.10.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt, në drejtim të:

8.1 *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi ankimi i tij në Gjykatën Administrative të Apelit është regjistruar më datë 4.5.2022 dhe për të ende nuk ka një vendimmarrje, duke u tejkaluar kështu afati 1-vjeçar i parashikuar nga neni 399/2, pika a, i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

8.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi argumentet e përdorura nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë për të rrëzuar kërkesën e tij nuk qëndrojnë, pasi, së pari, kërkuesi nuk kishte detyrimin për të paraqitur kërkesë për përshpejtimin përpara gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit që ka në shqyrtim çështjen e tij. Së dyti, argumenti për ngarkesën e çështjeve të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit nuk është pranuar nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe Gjykatës. Për më tepër, vonesa në gjykimin e çështjes nuk ka ardhur si rezultat i sjelljes së kërkuesit ose kompleksitetit të çështjes.

8.3 *Së drejtës së pronës*, pasi moskorrigjimi i të dhënave mbi pasurinë objekt gjykimi dhe moslëshimi i dokumentacionit të pronësisë në mënyrë të rregullt i ka shkelur kërkuesit të drejtën e disponimit lirisht të pronës.

8.4 *Së drejtës së informimit*, pasi mosdhënia e informacionit të kërkuar në objektin e padisë, konkretisht për emrin e subjektit pronar ose bashkëpronar mbi truallin funksional të pasurisë nr. 7/161, vol. 12, faqja 160, ZK nr. 8380 (pallat) Tiranë, si dhe shkakut ligjor të fitimit të pronësisë mbi këtë truall, e kanë penguar kërkuesin në ushtrimin e të drejtave të tij.

9. **Subjektet e interesuara, ASHK-ja dhe Drejtoria Vendore e ASHK-së, Tirana Veri**, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Për sa i përket legjitimitimit *ratione personae* të kërkuesit, në objektin e kërkesës ai ka kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm si rrjedhojë e mosgjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-2963, datë 13.7.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke i lidhur argumentet e tij me faktin se vonesa në gjykimin e çështjes i ka cenuar të drejtën e pronës. Për rrjedhojë, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione*

personae, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Për sa u përket kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike efektive që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individit duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë në përputhje me nenet 399/1 e vijues të KPC-së për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të çështjes gjyqësore administrative nr. 31151-01451-86-2022, nr. akti 16849, datë 4.5.2022 dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit. Me vendimin nr. 00-2023-2963, datë 13.7.2023, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, për rrjedhojë Gjykata çmon se kërkuesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000.

14. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm është i datës 13.7.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur fillimisht më datë 3.8.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

15. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, së drejtës së pronës dhe së drejtës së informimit, janë në funksion të pretendimit kryesor për tejzgjatjen e procedurave gjyqësore, i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

16. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, pasi ankimi i tij në Gjykatën Administrative të Apelit është regjistruar më datë 4.5.2022 dhe për të ende nuk ka një vendimarrje, duke u tejkaluar kështu afati 1-vjeçar i parashikuar nga neni 399/2, shkronja “a”, i KPC-së.

17. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset tek palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuuesi i është drejtuar gjykatës administrative të shkallës së parë me kërkesëpadi me objekt kryesor detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së dhe Drejtorisë Vendore, Tiranë Veri për të korrigjuar gabimin material që lidhet me sipërfaqen e apartamentit të regjistruar në të dhënat kadastrale. Gjykata administrative e shkallës së parë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë për kërkimet kryesore, vendim i cili është ankimuar nga subjektet e interesuara, si dhe është paraqitur kundërankim nga kërkuuesi. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit më datë 4.5.2022, pra aktualisht ka kaluar 1 vit e 11 muaj dhe ende nuk ka një vendimmarrje në lidhje me themelin e saj.

19. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka theksuar se neni 48 i ligjit nr. 49/2012 “ Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

20. Në këtë drejtim, paraprakisht, Gjykata vlerëson të theksojë se, sikurse tashmë ka konstatuar gjatë gjykimit të çështjeve që lidhen me kohëzgjatjen e paarsyeshme të afatit në parim, vonesa në gjykimin e çështjeve të individëve është pasojë e ngarkesës së lartë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, kjo gjendje është duke u zgjatur prej disa vitesh, prandaj edhe metodat e identifikuara nga vetë gjykatat dhe KLGJ-ja, në cilësinë e organit kushtetues që ka përgjegjësinë për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës), tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë (*shih vendimet nr. 61, datë 20.11.2023; nr. 68, datë 7.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në këto kushte, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të paarsyeshme të afatit, pra nëse kërkuessit i është cenuar e drejta kushtetuese e procesit të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuessit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuessit (*shih vendimet nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në lidhje me *sjelljen e kërkuessit* Gjykata vëren se ai, pas regjistrimit të çështjes në gjykatën e apelit më datë 4.5.2022, të nesërmen e kalimit të afatit 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë, sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës së Lartë, pra më datë 5.5.2023, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Sikurse pranohet edhe nga Gjykata e Lartë, nuk konstatohet ndonjë sjellje e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit e deri në momentin e marrjes së vendimit nga ajo gjykatë për çështjen e kërkuessit nuk është kryer asnjë veprim procedural. Ai nuk ka paraqitur kërkesë për përshpejtim në Gjykatën Administrative të Apelit, me argumentin se çështja e tij nuk bënte pjesë në kategorinë e çështjeve të përcaktuara në vendimin nr. 78/2019 të KLGJ-së. Pavarësisht këtij

fakti, Gjykata çmon se nuk duket që sjellja e kërkuarit të jetë bërë shkak për tejzgjatjen e gjykimit të çështjes së tij.

23. Për sa i takon *kompleksitetit të çështjes* Gjykata vëren se çështja ka natyrë administrative me të paditur ASHK-në dhe drejtorinë vendore të saj, me disa kërkitime në objektin e padisë, të cilat, në thelb, lidhen me korrigjimin e gabimit material në kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme të kërkuarit dhe në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe, për pasojë, nxjerrjen e aktit administrativ për kalimin e pronësisë, privatizimin e pjesës takuese të truallit shtetëror në përdorim, dorëzimin e kartelës së pasurisë së plotësuar dhe kthimin e vlerës përkatëse të tarifës. Gjykata administrative e shkallës së parë ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Gjykata Administrative e Apelit është vënë në lëvizje mbi ankimin e Avokaturës së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Tirana Veri, për të cilin kërkuari ka paraqitur kundërankim. Ashtu siç thekson edhe Gjykata e Lartë në vendimin për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit të çështjes dhe përsheptimit, çështja nuk paraqitet komplekse.

24. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, duke mbajtur në konsideratë për sa është theksuar më sipër për situatën aktuale të ngarkesës së sistemit gjyqësor (*shih paragrafin 20 të vendimit*), Gjykata, në shtesë, vëren se çështja e kërkuarit është në pritje për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit tashmë prej 1 viti e 11 muajsh, ndërsa kohëzgjatja totale e procedurave nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën e shkallës së parë është pothuajse 3 vjet. Nga të dhënat e marra nga Gjykata Administrative e Apelit (*shih paragrafin 4 të vendimit*), sikurse arsyeton dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin për rrëzimin e kërkesës së tij për konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit dhe përsheptimin e procedurave, gjykata e apelit është në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen e kërkuarit brenda afatit të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës së madhe dhe jo për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Prandaj në analizë të të dhënave të mësipërme, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuarit lidhet me ngarkesën e lartë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe të gjyqtarit relator, shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi.

25. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuari*, Gjykata vlerëson se çështja e tij, për shkak të natyrës së saj, nuk lidhet me interesa “vetjakë e jetësorë”, duke qenë se pretendimet e kërkuarit kanë të bëjnë me pamundësinë e disponimit të së drejtës së pronës në masën faktike të saj. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe kohën prej 1 viti e 11 muajsh për shqyrtimin e çështjes në raport me ngarkesën me të cilën përballon sistemi i drejtësisë, vlerëson se kjo çështje nuk rezulton të jetë e tillë që për shkak të natyrës së saj të ketë përparësi në radhën e shqyrtimit. Kërkuari, pavarësisht se ka barrën e provës në këtë drejtim, nuk ka paraqitur ndonjë argument se cenimi i së drejtës për të disponuar lirisht pasurinë i ka sjellë një pasojë të menjëhershme, jetike dhe ngushtësisht personale për t’i dhënë prioritet gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit. Edhe GJEDNJ-ja ka parashikuar listën e çështjeve të cilat kërkojnë “kujdes të veçantë” ose “kujdes të jashtëzakonshëm”, të tilla, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj.

26. Nisur nga sa më lart, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilit prej standardeve të lartpërmendura kushtetuese, Gjykata çmon se në rrethanat e rastit konkret, pavarësisht se formalisht afatet ligjore nuk janë respektuar, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkuarit në Gjykatën Administrative të Apelit në raport me situatën aktuale të ngarkesës në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, si dhe me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuari, nuk duket të ketë tejkaluar një kufi kohor të arsyeshëm në aspektin kushtetues, prandaj kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 4.4.2024.

Shpallur, më 2.5.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Marjana Semini, Genti Ibrahim